VENDIM
Nr. 913, datë 11.11.2015

PËR LEJIMIN E LËVIZJES, JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË 43 VIZATIMEVE TË AUTORËVE TË NDRYSHËM SHQIPTARË, PJESË E FONDIT TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE, PËR REALIZIMIN E EKSPOZITËS "RRUGËTIM SHQIPTAR: KOLEKSIONI I GKA-së DHE ARTISTË BASHKËKOHËS", NË KUADËR TË PROJEKTIT "NËNTORI SHQIPTAR", QË DO TË ZHVILLOHET PËRGJATË MUAJVE NËNTOR-DHJETOR 2015, NË DUSSELDORF-GJERMANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e lëvizjes, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të 43 (dyzet e tre) vizatimeve të autorëve të ndryshëm shqiptarë, objekte të rralla me vlera unikale, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, për realizimin e ekspozitës "Rrugëtim shqiptar: koleksioni i GKA-së dhe artistë bashkëkohës", në kuadër të projektit "Nëntori shqiptar", që do të zhvillohet përgjatë muajve nëntor - dhjetor 2015, në Dusseldorf-Gjermani, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Lejimi i lëvizjes së veprave bëhet për periudhën 19 nëntor - 8 dhjetor 2015.
3. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr.2, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".
4. Ngarkohen Galeria Kombëtare e Arteve të kryejë shoqërimin dhe kthimin e veprave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.
5. Ngarkohet ministri i Kulturës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama